



Agjencia për mbikëqyrje të financimit
kapital të sigurimit pensional

MISIONI DHE VIZIONI

● ● BULETINI ELEKTRONIK
● ● **E-MAPAS**
● ● NR.57

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS) ka rol kyç në sigurimin e stabilitetit, sigurisë dhe zhvillimit të sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë së Veriut. MAPAS, si institucion rregullator dhe mbikëqyrës, kujdeset vazhdimisht për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale, përmes kontrollit të punës së shoqërive pensionale dhe ndjekjes së menaxhimit me mjetet e fondeve pensionale.

Misioni i MAPAS është të mbrojë interesat e anëtarëve dhe të anëtarëve të pensionuar të fondeve pensionale dhe të nxisë zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital për ditë më të sigurta pensionale.

Vizioni i MAPAS është të njihet si institucion i pavarur, profesional dhe transparent, i cili në mënyrë aktive mbron dhe avancoon sigurimin pensional me financim kapital.

Në drejtim të realizimit të misionit dhe vizionit të saj, MAPAS i definon tri qëllimet kryesore strategjike.

QËLLIMI STRATEGJIK 1:

Sigurimi i menaxhimit me rreziqet që u kanosen mjeteve dhe pensioneve si dhe kompensimeve pensionale të anëtarëve të fondeve pensionale, si dhe reputacionit të sistemit, dhe reduktimi i tyre në nivelin më të ulët të mundshëm.

Qëllimi i parë strategjik është i orientuar drejt menaxhimit me rreziqet në sigurimin pensional me financim kapital, me qëllim mbrojtjen e mjeteve të anëtarëve të fondeve pensionale. Duke pasur parasysh se kursimi pensional është një proces afatgjatë, MAPAS i kushton vëmendje të veçantë kontrollit të investimeve dhe analizës së rreziqeve. Përmes mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe zbatimit të qasjes së bazuar në rrezik, synohet të sigurohet siguria e mjeteve dhe të minimizohen ndikimet potenciale negative mbi sistemin.

Ky qëllim realizohet përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- Realizimi i mbikëqyrjes jashtë terrenit të shoqërive dhe fondeve pensionale në bazë të raporteve dhe të dhënave të dorëzuara
- Realizimi i mbikëqyrjes në terren të bazuar në rrezik ndaj shoqërive pensionale dhe ruajtësve të pronës
- Shqiptimi i rekomandimeve dhe vërejtjeve për përmirësimin e punës së shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale
- Puna e Komitetit për vlerësimin e rreziqeve (analiza e rreziqeve, ndjekja e trendeve, propozimi i masave).

QËLLIMI STRATEGJIK 2:

Avancimi dhe mirëmbajtja e një sigurimi pensional me financim kapital stabil dhe transparent, i cili ka mbështetjen e anëtarësisë dhe të publikut.

Qëllimi i dytë strategjik i referohet punës së MAPAS për përmirësimin e kushteve për funksionimin e shoqërive pensionale, zhvillimin e mundësive të reja investuese dhe rritjen e transparencës në punë. Rëndësi të veçantë ka sigurimi i informatave të qarta dhe të kuptueshme për anëtarët e fondeve pensionale, me qëllim që ata të jenë më mirë të informuar për të drejtat e tyre dhe për gjendjen e mjeteve të tyre. Plotësisht, i kushtohet vëmendje cilësisë së shërbimeve, përditësimit të të dhënave dhe sigurisë në procesin e pagesës së pensioneve, gjë që kontribuon në ndërtimin e besimit në sigurimin pensional me financim kapital.

- Ky qëllim realizohet përmes aktiviteteve të mëposhtme:
- Miratimi i akteve nënligjore (rregullore, vendime dhe udhëzime) për rregullimin e sigurimit pensional me financim kapital
- Dhënia e pëlqimeve për punën e shoqërive pensionale
- Përgatitja e raporteve statistikore dhe analizave për sigurimin pensional me financim kapital
- Mirëmbajtja e mjetit statistikor ueb MAPAS-STAT

MAPAS-STAT vegël për të dhënat statistikore | Mapas

MAPAS-STAT vegël për të dhënat statistikore

Вредност на сметководствена единица и нето средства

Структура на инвестиции на пензиски фонд

Вкупна структура на инвестиции на задолжителните пензиски фондови

Вкупна структура на инвестиции на доброволните пензиски фондови

Членство во задолжителен пензиски фонд

- Identifikimi dhe ndjekja e rreziqeve sistemike dhe pjesëmarrja në politikën makroprudenciale
- Organizimi i provimeve dhe regjistrimi i agjentëve të shoqërive pensionale
- Mbajtja e regjistrit të anëtarëve të fondeve pensionale të detyrueshme

- Informimi i anëtarëve dhe sigurimi i mjetit për verifikimin e anëtarësimit
Verifiko në cilin fond pensional të detyrueshëm je anëtar! - Mapas | Mapas

Kontrollo në cilin fond penzional të detyrueshëm je anëtar!

VENDOSNI **NUMRIN AMË** PËR TË KONTROLLUAR SE NË CILIN FOND PENZIONAL JENI ANËTAR:

Pajtohem me [politikën e privatësisë](#)

I'm not a robot



DËRGOJ

- Trajtimi i kërkesave të anëtarëve dhe i ankesave
- Realizimi i aktiviteteve për edukim financiar dhe forcim të vetëdijes publike
Materiale edukative dhe video - Mapas | Mapas

ЕДУКАЦИЈА | Edukativni materijali и видеа

Edukativni materijali

Edukativni видеа

Интервјуа

Брошура со најчесто поставувани прашања

Брошура – “Ако ти е рано за пензија, не ти е рано за [penzija.mk](#)”

Паметно управување со парите

QËLLIMI STRATEGJIK 3:

Përmirësimi i kapacitetit në drejtim të forcimit të rolit të vet mbikëqyrës dhe rregullator në sigurimin pensional me financim kapital.

Qëllimi i tretë strategjik është i orientuar drejt forcimit të kapaciteteve institucionale të MAPAS-it, si parakusht për zbatimin e sukseshëm të kompetencave të saj. Kjo nënkupton avancimin e vazhdueshëm të njohurive dhe shkathtësive të punonjësve, përmirësimin e proceseve organizative dhe aplikimin e standardeve bashkëkohore për cilësi dhe siguri të informatave. Përmes zhvillimit të burimeve njerëzore, vendosjes së standardeve ndërkombëtare dhe realizimit të kontrolleve dhe evaluimeve të rregullta, MAPAS siguron punë efikase, profesionale dhe transparente.

Ky qëllim realizohet përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- Avancimi i profesionalizmit të punonjësve
- Zhvillimi dhe avancimi i proceseve të punës dhe organizimit
- Avancimi i sistemeve TI dhe automatizimi
- Bashkëpunimi me trupa tjerë mbikëqyrës në vend dhe jashtë vendit
- Mirëmbajtja e standardeve ISO për cilësi dhe siguri të informatave
- Përgatitja dhe publikimi i informatave për punën e MAPAS-it

Roli i MAPAS-it nuk kufizohet vetëm në mbikëqyrje dhe kontroll, por në ndërtimin e një sistemi në të cilin qytetarët do të kenë besim se kursimet e tyre janë të sigurta dhe të menaxhuara me përgjegjësi. Përmes përkushtimit të saj ndaj stabilitetit, transparencës dhe avancimit të vazhdueshëm, MAPAS përpiqet të krijojë një mjedis në të cilin siguri pensional nuk është vetëm obligim, por siguri për të ardhmen.

Me realizimin e këtyre qëllimeve, MAPAS kontribuon në krijimin e një sistemi pensional stabil dhe të qëndrueshëm i cili siguron siguri për qytetarët dhe të ardhurat e tyre të ardhshme pensionale.

”

„Qëllimi e shndërron
planin në rezultat“

”

„Mbikëqyrja është
mekanizëm për
përmirësim, e jo vetëm
për kontroll“

PËRFAQËSUES I MAPAS NË SHËNIMIN E 20-VJETORIT TË PUNËS SË HANFA-S

Marija Popovska, këshilltare e Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve të MAPAS-it, mori pjesë në akademinë solemne me rastin e shënimit të 20-vjetorit të punës së Agjencisë Kroate për Mbikëqyrjen e Shërbimeve Financiare (HANFA), e cila u mbajt në Zagreb.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



PUNËTORI INTERAKTIVE PËR EDUKIM FINANCIAR – „FUTURE MILLIONAIRE CHALLENGE“

MAPAS, së bashku me shoqëritë pensionale, Shoqëria e Parë Pensionale BK, Shoqëria Pensionale SAVA dhe TRIGLLAV, zhvilluan punëtorinë “Future Millionaire Challenge”, në organizim të Kuvendit Studentor Universitar, e dedikuar për studentët, me qëllim avancimin e edukimit financiar dhe rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e planifikimit afatgjatë dhe kuptimin e sistemit pensional si pjesë e së ardhmes së tyre.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



MUNDËSI PËR BASHKËPUNIM INSTITUCIONAL DHE AKADEMIK – TEMË E TAKIMIT MES RAMZI BAJRAMIT DHE PROF. DR. ABDULMENAF BEXHETIT

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimeve Pensionale me Financim Kapital, Ramzi Bajrami, zhvilloi takim pune me prof. dr. Abdulmenaf Bexhetin, profesor në Universitetin e Evropës Juglindore, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë së Veriut dhe njohës i shquar i financave dhe çështjeve ekonomike që ndërlidhen me sferën që mbulon institucioni.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



U MIRATUA RAPORTI MBI PUNËN E KOMITETIT TË STABILITETIT FINANCIAR PËR VITIN 2025: STABILITETI FINANCIAR ËSHTË RUAJTUR

Komiteti i Stabilitetit Financiar, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2026, shqyrtoi Raportin mbi Punën e Komitetit dhe Nënkomiteteve të vitin 2025, gjatë të cilit u përcaktua se stabiliteti financiar është ruajtur dhe se sistemi financiar tregon qëndrueshmëri dhe aftësi të mirë për t'u përballur me sfidat.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



JAVA GLOBALE E PARASË 2026: “BISEDA PËR MENAXHIM TË MENÇUR TË PARAVE”

Banka Popullore, Ministria e Financave, Komisioni për Letra me Vlerë, Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimit Pensional me Financim Kapital (MAPAS) dhe Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, në bashkëpunim me shoqatat dhe institucionet nga sektori privat dhe ai civil që janë aktive në fushën e edukimit financiar, në periudhën 16–22 mars 2026, për të katërmbëdhjetin vit me radhë do ta shënojnë Javën Globale të Parasë.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.

Save the date!

GLOBAL MONEY WEEK 2026 LAUNCH

DATE 16 March 2026
TIME 12:00 - 13:30 CET
THEME Smart Money Talks

Organised by the OECD
International Network on Financial Education (INFE)

MAPAS MORI PJESË NË PREZANTIMIN E RAPORTIT PËR EDUKIMIN FINANCIAR TEK NXËNËSIT

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimit Pensional me Financim Kapital (MAPAS), Remzi Bajrami, dhe Këshilltarja e Kryetarit, Marija Popovska, morën pjesë në ngjarjen për prezantimin e Raportit mbi edukimin financiar tek nxënësit, të përgatitur nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



NGJARJE EDUKATIVE NË FAKULTETIN EKONOMIK: MAPAS DHE SHOQËRITË PENSIONALE INKURAJOJNË TË RINJTË DREJT “SMART MONEY TALKS” PËR NJË TË ARDHME MË TË MIRË FINANCIARE

Në kuadër të shënimit të Global Money Week 2026, sot në Fakultetin Ekonomik u mbajt aktivitet edukativ në bashkëpunim me prof. Elena Naumovska, dedikuar rritjes së edukimit financiar tek të rinjtë. Në këtë aktivitet, përfaqësues i MAPAS-it së bashku me përfaqësues nga tre shoqëritë pensionale BK Shoqëria e Parë Pensionale SHA Shkup, Shoqëria Pensionale Sava SHA Shkup dhe Shoqëria Pensionale Trigllav Shkup, hapën diskutim me temë “Smart money talks”, e cila shënon Javën Globale të Parasë 2026 (GNP).

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



MAPAS ME PUNËTORI INTERAKTIVE NË SHFK „SHËN KLIMENTI I OHRIT“ ME RASTIN E JAVËS GLOBALE TË PARASË

Në kuadër të shënimit të Global Money Week (Javës Globale të Parasë), përfaqësues nga Agjencia për Mbikëqyrjen e Sigurimit Nacional Pensional me Financim Kapital (MAPAS), së bashku me përfaqësues nga shoqëritë pensionale “KB Prvo penzisko drushtvo”, “Sava penzisko drushtvo” dhe “Triglav penzisko drushtvo”, mbajtën një takim me kuadrin mësimdhënës dhe realizuan një punëtori interaktive në SHFK „Shën Klimenti i Ohrit“ në Komunën e Butelit.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



www.mapas.mk



[mapas.mk](https://www.facebook.com/mapas.mk)



[mapas.mk](https://www.instagram.com/mapas.mk)



[mapasmk](https://www.linkedin.com/company/mapasmk)

PJESËMARRJA E MAPAS NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE PËR BANKA QENDRORE NË KUSHTET E NDRYSHIMEVE GLOBALE

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimit Pensional me Financim Kapital (MAPAS), Remzi Bajrami, së bashku me anëtarin e Këshillit të Ekspertëve, Pranvera Suma, morën pjesë në një Konferencë Ndërkombëtare të nivelit të lartë, të organizuar nga Banka Popullore, në bashkëpunim me Forumin Evropian për Para dhe Financa (SUERF – The European Money and Finance Forum), me temë: “Bankat qendrore në kushtet e ndryshimeve të vazhdueshme globale: nxitja e stabilitetit, inovacionit dhe qëndrueshmërisë”.

Për më shumë informacione vizitoni [linkun](#) e mëposhtëm.



KENI PYETJE OSE ANKESA?
Paraqituni në MAPAS ose shkruani një mesazh në
contact@mapas.mk

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional (MAPAS)
Slavko Janevski 100, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
Тел: (02) 3224 229
www.mapas.mk



МКС EN ISO 9001:2009